

Nr. .... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Fierzë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2023

## **LENDA: SPECIFIKIMET, DETYRE PROJEKTIMI PER HARTIM PROJEKT-ZBATIMI DHE REALIZIMI I PUNIMEVE "KONTRATE ME ÇELËSA NË DORË"**

### **OBJEKTI: " Mbilartësimi i mbrojtjes lumore përballë tuneleve të shkarkimit dhe sistemimi i sheshit pranë magazines së re"**

#### **1. HYRJE. PËRSHKRIMI I SITUATËS AKTUALE**

HEC Fierza ndodhet në veri të Shqipërisë mbi shtratin e lumit Drin, ndërtimi i së cilës ka filluar punë në vitin 1978. Ndërtesa e çentralit të HEC Fierzë ndodhet në bregun e majtë të rrjedhës, pranë fundit të digës ndërsa në bregun e djathtë të rrjedhës ndodhen 2 shkarkuesit të cilët në rastet e plotave të mëdha janë parashikuar të shkarkojnë deri në 2670 m<sup>3</sup>/sek.

Diga e HEC Fierzës me lartësi 161.5 m është digë me material vendi dhe me bërthamë argjile dhe është diga më e lartë në vendin tonë e këtij lloji dige. Bazuar në analizën e riskut për digat e kaskadës së lumit Drin sipas rekomandimeve të ICOLD, kjo digë klasifikohet si digë e klasit të parë. Diga është përfunduar së ndërtuari në vitin 1978 si rrjedhojë e të cilës është krijuar liqeni i Fierzës me vëllim 2.7 miliard m<sup>3</sup> dhe sipërfaqe prej 72.5 km<sup>2</sup>. Niveli i kurorës së digës është 312.00 metra mbi nivelin e detit (mmnd).

Afërsisht 500 metra pas daljes së shkarkuesve aktualisht ekziston një urë rrugore që pret tërthorë lumin Drin dhe shërben për rrugën kombëtare që lidh qytetin e Bajram Currit me qytetin e Pukës.

Shkarkuesit përbëhen nga dy tunele të veshur me beton të cilët ndodhen në shpatin / bregun e djathtë të lumit Drin. Këto dy tunele, të përcaktuara si tuneli i shkarkimit nr. 3 dhe nr. 4, kanë karakteristika të përgjithshme shumë të ngjashme siç janë vepra marrjes në formën e kullës beton-arme, ku janë vendosur portat radiale të punës dhe portat e mirëmbajtjes. Sistemi i portave është i njëjtë për të dy tunelet e shkarkimit me përjashtim të faktit që sistemi i operimit të tunelit nr. 4 është më cilindra hidraulike. Vepra e marrjes së ujit në tunelin e shkarkimit nr. 3 është e aksesueshme nga kurora e digës përmes një ure të varur metalike ndërsa vepra e marrjes së ujit në tunelin e shkarkimit Nr. 4 është e aksesueshme përmes shkallëve.

Rrymat e prodhuara nga shkarkimi i shkarkuesave godasin në zonën e bjefit të poshtëm pas trajektoresh të gjata parabolike që rrisin përmbajtjen e ajrit dhe shpërndarjen e rrymës. Zonat që goditen nga rrymat e ujit të dala nga shkarkuesit, janë të vendosura midis hundëzave të shkarkuesëve në krahun e djathtë të lumit dhe urës rrugore në bjefin e poshtëm, në një distancë prej rreth 350 m nga hundëza e daljes së këtyre tuneleve.

Sipas përshkrimit të punës së tuneleve të shkarkimit të digës gjatë jetës së tyre, në fazat e mëvonshme të ndërtimit, niveli i ujit në rezervuarin e bjefit të sipërm është kontrolluar nga devijimi i ujrave të tepërta nëpërmjet shkarkuesit nr. 3. Kushtet hidraulike ishin të tilla që rryma e shkarkuar nga tuneli nuk zhvillohej plotësisht sipas një trajektoreje parabolike, për këtë arsye u vërejt dhe erozion i konsiderueshëm në skarpatën e majtë sa herë që ka pasur një operacion në këto kushte hidraulike. Me qëllim mbrojtjen e shpatit gjatë devijimit të lumit nëpër këtë tunel shkarkimi, janë marrë masa të ndryshme në kohë të ndryshme, përkatësisht përdorimi i blloqeve të mëdha të betonit përgjatë shpatit, të cilët janë të ankoruar me njëri tjetrin në mënyrë sekuenciale dhe së fundmi, blloku i parë është ankoruar në themelin e hundëzës.

Funksionimi i tuneleve të shkarkimit që kur diga ka hyrë në shërbim, ka çuar në dëme të pjesëshme në zonën përballë tyre. Zona përballë këtyre tuneleve në pjesën e poshtëme deri tek zona e urës mbi lumin Drin ka një shtrirje të mbrojtur të gjatë para aksit të trajektorese së rrjedhës.

Zona përballë këtyre tuneleve të shkarkimit përfshin edhe rrugën bashkë me shpatullën e majtë të urës rrugore të cilat kanë pas qenë të dëmtuara në mënyrë progresive nga rrymat e krijuara nga puna e tunelit të shkarkimit, shkak i cili çoi në rindërtimin dhe mbrojtjen e shpatit të majtë, që përfshin skarpatën e betonizuar ekzistuese poshtë rrugës, rrugën e re që lidhet me urën si dhe dy hapësirat shtesë të urës të ndërtuara gjatë vitit 2012.

Ndërtimi gjeologjik i zonës ku janë vendosur objektet e HEC Fierzës karakterizohet nga prania e formacioneve shkëmbore të cilat përfshihen në shpërndarjen hapësinore të tre zonave tektonike. Të tre zonat përfaqësojnë shkëputje tektonike me karakter mbizhvendosës. Ato janë formuar në fazat e mbivendosjes së zonës gjeologjiko-tektonike "Mirdita" e njohur si zonë e shkëmbinjëve magmatikë. Kjo trysni ka bërë që brënda kësaj pyke tektonike të formohen shumë rrudhosje dhe mikrorrudhosje të shoqëruara edhe me shkëputje tektonike. Sipas zonimit sizmik të hartuar nga Instituti i Sizmikës, zona konsiderohet të jetë me intensitet 8 ballë të shkallës Merkali.

Zona e digës përfaqësohet nga shkëmbinjte magmatike dhe efuzivo-sedimentare. Shkëmbinjte magmatikë përfaqësohen nga shkëmbinjte granite, ophiolite, diabaze dhe keratofire. Bazamenti kryesor i digës është i ndërtuar mbi granite dhe pllajjiogranite ndërsa tunelet e shkarkimit dhe strukturat e tjera janë në kontakte tektonike të ndryshme dhe në zona me qendrueshmëri të ulët gjeologjike.

Shkarkuesit e HEC Fierzë (sikurse e përmendëm edhe më sipër janë dy të tillë, nr. 3 & nr. 4) ndodhen në shpatin e djathtë të digës së HEC Fierzë. Nisur nga skema e operimit me këto shkarkues, operohet gjithmonë me shkarkuesin nr. 4, ndërsa shkarkuesi nr. 3, është kapacitet shtesë për shkarkim. Gjatë gjithë historikut të HEC Fierzë, shkarkuesi nr. 3 thuhet nuk është përdorur kurrë. Madje duke filluar që nga viti 1988, edhe testimet e këtij shkarkuesi, kryhen me një procedurë të veçantë, kjo për shkak të komplikimeve që mund të shkaktonte operimi me të tek zona përballë këtij shkarkuesi.

Zona përballë shkarkuesve është një zonë me qendrueshmëri të ulët dhe si pasojë e shkarkimeve nga tuneli i shkarkimit Nr. 4 (kapaciteti total i këtij shkarkuesi sipas projektit është 890 m<sup>3</sup>/sek), në zonën e anës së majtë të rrjedhës së lumit, poshtë digës së Fierzës kanë pas qenë vërejtur dëmtime të mëdha të shpatit sidomos në zonën në afërsi të urës së lumit Drin. Këto dëmtime jo vetëm që mund të cënonin sigurinë e objekteve që ndodhen pranë tyre por mund të cënonin edhe rrugën kombëtare e cila shërben për të lidhur jo vetëm qytetet e Bajram Currit me qytetin e Pukës por shërben edhe si rrugë kryesore për akses në kurorën e digës së Fierzës dhe objektet kryesore të HEC Fierzë si vepra e marrjes së uji, portat e shkarkuesve nr. 3 dhe nr. 4, nënstacioni elektrike, etj. Për këtë arsye KESH gjatë viteve të fundit, zhvilloi një projekt relativisht të madh për sa i përket volumit dhe kostove të punimeve dhe me një rëndësi të veçantë si për sigurinë e veprës, ashtu edhe për utilizimin e operimit edhe me tunelin numër 3 të shkarkimit. Fjala është për projektin me objekt "Masat Mbrojtëse në anën e majtë të rrjedhës përballë daljeve të tuneleve të shkarkimit nr. 3 dhe nr. 4 në biefin e poshtëm të digës së Fierzës nga ura e rrymëshpejtuesit deri tek ura mbi lumin Drin".

Tashmë që ky projekt është finalizuar, ka mbetur të sistemohet skarpatat e bregut në kanalin e daljes së ujit nga çentrali i HEC Fierzë dhe tuneleve të shkarkimit gjithashtu. Sistemimi i kësaj skarpatat mundëson edhe krijimin e një sheshi të madh në zonën ku ndodhet edhe magazina e re (përballë daljes së shkarkuesve nr. 3 & 4). Për këtë arsye KESH sh.a në përputhje me programin ekonomik 2023, kërkon të realizojë projektin e zbatimit me objekt "Mbilartësimi i mbrojtjes lumore përballë tuneleve të shkarkimit dhe sistemimi i sheshit pranë magazines së re".

Gjithashtu, në bazë të ligjit Nr.8681.date 02.11.2000 "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", si dhe të Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.147, date 18.03.2004, KESH sh.a si shfrytëzuesi i këtij objekti, është përgjegjësi kryesor për sigurinë e digës dhe nënobjekteve të tjera që lidhen me të dhe për pasojat që rrjedhin nga prishja ose aksidentet e mundshme që mund të ndodhin. Tërësia e masave organizative, teknike dhe financiare që merr shfrytëzuesi i objektit, duhet të garantojë shfrytëzimin normal të objektit, jetëgjatësinë e tij dhe moscënimin e të tretëve.

Zbatimi i punimeve sipas projekt zbatimit të murit të betonit mbi pilotat beton-arme, të përfunduar gjatë vitit 2020, nuk e ka bërë të mundur sistemimin e sheshit para magazines, kjo sepse nuk ishte qëllimi i tij dhe sepse

ka një disnivel ndërmjet sheshit para magazinës dhe murit të përfunduar i cili varion mesatarisht rreth 8 metra lartësi. Mbilartësimi i murit të pilotuar deri në kuotën e tokës para sheshit të magazinës bën të mundur parandalimin e fenomenit të erozionit mbi skarpatën e pambrojtur mbi pilota, si dhe krijon një sipërfaqe shtesë për parking të automjeteve, sipërfaqe që është shumë e domozdoshme të posedohet në oborrin e HEC Fierzë, i cili ndryshe nga HEC-et e tjera, ka sipërfaqe shumë të vogël.

Për sa me sipër, KESH sh.a kërkon të realizojë këto punime sikurse më lart i përshkruam duke hartuar një projektzbatim ku të saktësohen volumet dhe kostot finale për realizimin e tij, si dhe zbatimin e punimeve për objektin "Mbilartësimi i mbrojtjes lumore përballë tuneleve të shkarkimit dhe sistemimi i sheshit pranë magazines së re".

## **2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVI I KËTJ SHËRBIMI.**

Pas realizimit të projektit me objekt "Masat Mbrojtëse në anën e majtë të rrjedhës përballë daljeve të tuneleve të shkarkimit nr. 3 dhe nr. 4 në biefin e poshtëm të digës së Fierzës nga ura e rrymëshpejtuesit deri tek ura mbi lumin Drin", janë reduktuar apo eliminuar gërryerjet e mëdha që paraqesin zonat në krahun e majtë të rrjedhjes në pjesën e poshtme të digës së Fierzës përballë daljes së këtyre tuneleve. Pikërisht mbi mbrojtjen e realizuar (mbi murin dhe pilotat e injektuara në këtë mbrojtje), me qëllim sistemimin e skarpatës në këtë breg dhe zgjerimin dhe shfrytëzimin e sheshin para magazinës së re për parking automjetesh, hartojmë këto kërkesa për të siguruar një projekt-zbatim dhe për të realizuar punimet në objektin "Mbilartësimi i mbrojtjes lumore përballë tuneleve të shkarkimit dhe sistemimi i sheshit pranë magazines së re", i cili do t'i japë zgjidhje të gjitha problemeve të mësipërme.

Zona për të cilën do të hartohet projekti ndodhet në pjesën e poshtme të digës së HEC Fierzë, pra tek sheshi para magazinës dhe përgjatë murit të pilotuar gjatë vitit 2020. Në anën e sipërme të kësaj zone ndodhet diga e Fierzës, në anën e majtë të drejtimit të rrjedhës ndodhen ndërtesa e centralit, magazina e HEC Fierzë, rruga kombëtare dhe rruga hyrëse në HEC Fierzë dhe në anën e poshtme të kësaj zone ndodhet ura mbi lumin Drin e ndërtuar gjatë fazës së ndërtimit të HEC Fierzë dhe e zgjeruar në vitin 2012.

Finalizimi i ndërtimit / sistemimit të skarpatës së bregut të majtë të kanalit të daljes së ujit, rreth e rrotull hapsirës tek magazine e re përballë daljes së tuneleve të shkarkimit nr. 3 & 4 dhe shndërrimi i saj në shesh parkimi (dhe jo vetëm për parkim) të mbuluar, është qëllimi kryesor i kësaj sipërmarrjeje.

## **3. DETYRA KRYESORE QË DUHET TË ZGJIDHEN GJATË HARTIMIT TË PROJEKTIT**

Nëpërmjet projektit të zbatimit me objekt "Mbilartësimi i mbrojtjes lumore përballë tuneleve të shkarkimit dhe sistemimi i sheshit pranë magazines së re", dhe më pas realizimit të punimeve për këtë projekt, përftohet / zgjerohet sheshi para magazinës për të krijuar parkingun e nevojshëm për automjetet që ka në përdorim hidrocentrali Fierzë dhe përmirëson infrastrukturën e sheshit para magazinës për çfarëdo lloj shërbimi operacional dhe mirëmbajtës në HEC Fierzë.

Në realizim të detyrës së mësipërme fillimisht kontraktori, duhet të studiojë:

- Evidentimin e zonave me qendrueshmeri të ulët, në skarpatën mbi murin e pilotuar, që janë nën ndikimin e erozionit dhe mënyrën e ndërhyrjes për mbrojtje.
- Gjendjen aktuale të sheshit ekzistues dhe problemeve që krijon disnivele ndërmjet murit të pilotuar dhe sheshit para magazinës.
- Pozicionimin e sheshit për parkimin e automjeteve, duke lënë hapsirën e nevojshme përpara magazinës, me qëllim që automjetet e transportit që kanë lidhje me objektin e magazinës të kenë hapsirën e nevojshme për të qarkulluar në perimetrin e saj.

Mbi bazën e studimeve të mësipërme të jepen zgjidhjet inxhinierike efikase nëpërmjet:

- Raport gjeologjiko inxhinierik dhe gjeoteknik i zonës ku do të zbatohet projekti. Gjithashtu, studimi duhet të japë edhe vendndodhjet e karierave të mundëshme të marrjes së materialeve për ndërtimin e strukturave mbrojtëse që mund të parashikohen.

- Rilevimi topografik të zonës, ku do të planifikohet mbrotja lumore shesistemimi i sheshit tek magazina.
- Përcaktimin e sheshit dhe kthimin e tij në parking të mbuluar.
- Sistemimi dhe shkarkimi i ujrave sipërfaqësore të shiut, mbi sipërfaqen e sheshit të sistemuar.
- Sistemimi i infrastrukturës inxhinierike.

Zbatimi i kësaj sipërmarrjeje do të kalojë në dy faza kryesore, në **fazën e parë** që do të jetë hartimi i projektit të zbatimit dhe më pas në **fazën e dytë**, zbatimi i punimeve. Vetë faza e parë do të kalojë në dy etapa. Në etapën e parë do të jetë hartimi i Projekt-Idesë dhe preventivit paraprak, ku do të kërkohet të bëhet studimi i plotë dhe kompleks për një zgjidhje sa më të mirë për sistemimin e sheshit para magazinës dhe kthimin e tij në parking të mbuluar për automjetet. Për këtë duhet të analizohet struktura mbrojtëse për mbilartësimin e murit ekzistues. Për të realizuar detyrat e kësaj etape të hartimit të projektit, duhet të kryhen të paktën këto aktivitete:

- Rilevimi topografik i zonës në anën e majtë të rrjedhës deri tek rruga kombetare, në shkallën që do të gjykohej nga projektuesi.
- Studimi, analiza dhe konkluzionet për opsionet e mundëshme të mënyrave të sistemimit të sheshit dhe kthimi në parking automjetesh.
- Vlerësimi i volumeve, të materialit për mbushje.
- Vlerësimi paraprak i ndikimit në mjedis sipas VKM 686, date 29.07.2015.

Projektuesit duhet të kenë paraysh:

- Kriteret e projektimit dhe treguesit kryesore që duhet të jenë sipas kushteve teknike të projektimit të ndërtimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Studimet dhe projektet e zbatuara më parë, si dhe gjendjen aktuale të zonës.
- Materialet që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike të projektimit të ndërtimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Projekti paraprak teknik do të aprovohet fillimisht nga HEC Fierza dhe më pas edhe nga DGj/DSD në KESH sh.a.

Etapa e dytë e fazës së parë do të jetë hartimi i Projektit Final për zbatim, ku kërkohet të paraqitet një projekt zbatim i plotë i shoqëruar me vizatimet përkatëse, specifikimet teknike, preventivin e punimeve që do të kryhen, grafikun dhe organizimin e punimeve, si dhe të shoqëruar me raportet ndihmëse topografike, gjeologjike – inxhinierike, VNM, etj

Projekti i Zbatimit që do të paraqitet në fund të kësaj etape të fazës së parë të kësaj kontrate, duhet të përmbajë:

- Relacionet teknike të shoqëruara me llogaritjet përkatëse për të gjitha masat inxhinierike të parashikuara, si dhe raportet ndihmëse për topografinë, gjeologjinë, hidrogjeologjinë, dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis.
- Vizatimet teknike për të gjitha ndërhyrjet inxhinierike të propozuara si dhe për çdo objekt në veçanti të shoqëruara me profilet tërthore dhe gjatësore.
- Specifikimet teknike për çdo objekt ku të përcaktohen materialet që do të përdoren, të dhënat fiziko-mekanike të tyre etj.
- Volumet e punimeve të ndara për çdo objekt në veçanti dhe për të gjithë projektin në tërësi.
- Preventivimin e punimeve sipas normave dhe standarteve në fuqi dhe të ndara për çdo objekt në veçanti dhe për të gjithë projektin në tërësi, bazuar në çmimet e miratuara nga institucionet përkatëse.
- Organizimi i punimeve që do të kryhet, të përshkruhet në kalendarin e punimeve i ndarë për çdo zë / objekt në veçanti, sipas radhës së punës që vetë projekti përshkruan.

Të gjitha dokumentat e projektit të zbatimit duhet të jenë hartuar në gjuhën shqipe. Projekti i Zbatimit do të aprovohet nga një komision teknik që do të ngrihet fillimisht nga HEC Fierza dhe më pas edhe nga DGj/DSD në KESH sh.a.

Faza e dytë lidhet me zbatimin e punimeve. Zbatimi i punimeve do të fillojë menjëherë pas miratimit të projektit nga komisioni përkatës i ngritur nga KESH sh.a. Kontraktori duhet të zbatojë me përpikmëri projektzbatimin e miratuar nga HEC Fierza dhe nga DGj/DSD në KESH sh.a. Zbatimi i projektit do të drejtohet nga Mbikqyrësi i Punimeve që do të emërohet nga investitori.

#### **4. STANDARTET TEKNIKE TË HARTIMIT TË PROJEKTIT.**

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve teknike të projektimit dhe të zbatimit. Në mënyrë të veçantë, projekti duhet të respektojë të gjitha etapat e përgatitjes së tij, sipas kërkesave të Ligjit nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e digave dhe Dambave" si dhe të VKM Nr.147, dt. 18.03. 2004.

Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse në fuqi. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të bëshëmërisë dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe kufizimet për financimin e veprës. Detajet teknike duhet të jepen nga projektuesi në fletë të veçanta të projektit. Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet kompjuterike përkatëse, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara në këtë fushë.

#### **5. PROFILI I EKSPERTËVE PROJEKTUES.**

Ekipi i projektimit duhet të demonstrojë aftësi, eksperiencë dhe mundësi teknike dhe profesionale në fushën e kryerjes së studimeve dhe projekteve të tilla. Ai duhet të demonstrojë eksperiencat në fushën e studimeve dhe projekteve të sistemeve të mbrojtjes lumore në veçanti dhe të veprave hidroteknike në përgjithësi. Ekipi duhet të vendosë në dispozicion informacionin e duhur në lidhje me eksperiencën e tij në projekte të ngjashme dhe duhet të përbëhet nga ekspertët e mëposhtëm dhe të mos kufizohet në;

- Drejtuesi i ekipit të projektit i licencuar për studime projekte në fushën e ndërtimeve civile dhe mbrojtjeve lumore.
- Inxhinier gjeolog i licencuar.
- Inxhinier gjeodet i licencuar.
- Inxhinier hidroteknik i licencuar
- Inxhinier ndertimi i licencuar

Projekti i hartuar sipas termave dhe kërkesave të mësipërme do të zbatohet në një kohe sa më të shkurtër të mundshme teknikisht. Për këtë qëllim kërkohet që në projekt të parashikohet zbatimi i punimeve me një fazë dhe një rrjedhe logjike inxhinierike duke maksimalizuar efektet e tij në plotësim të qëllimit final si dhe kushtet e menaxhimit të kaskadës së lumit Drin nga ana e KESH sh.a.

#### **6. AKTIVITETET.**

##### **6.1 Aktiviteti në Fazën e Parë.**

Sikurse në pikë nr. 3 të këtij dokumnti kemi përmendur se kjo sipërmarrje do të kryhet në dy Faza, në vijim po i shtjellojmë më shumë ato. Faza e parë do të ndahet në dy etapa.

##### **6.1.1 Etapa e Parë – Mobilizimi dhe përgatitja e variantit fillestar të projektit të zbatimit.**

Mobilizimi do të jetë një periudhë intensive planifikimi, kërkimi, investigimi dhe konsultimi, në mënyrë që të sigurojë fazën parapërgatitore dhe atë të analizimit sa më shpejt të problematikës që duhet të zgjidhet në kuadër të këtij projekti.

Këtu përfshihet:

- faza e kontrollit të gjëndjes aktuale në vend,
- Shqyrtimi i dokumentacionit teknik që është i disponueshem, rezultateve të matjeve dhe modelimeve të kryera më parë, etj.

Për kompletimin e kësaj faze, parashikohet;

- Vizita në hidrocentralin e Fierzës për t'u njohur nga afër me zonën dhe problematikën e parashtruar në këtë detyrë projektimi. Numri i vizitave në terren i ekipit të projektit do të jetë në funksion të kërkesave të tyre.
- Takime dhe diskutime me personelin e DGj/DSD dhe HEC Fierzë për shkëmbimin e informacioneve dhe këndvështrimeve në lidhje me aspekte specifike dhe detyrën që do të realizohet.
- Marrja e të dhënave dhe studimi i tyre për të gjithë informacionin e siguruar nga vëzhgime, raporte teknike, fotografime, filmime, të dhëna të evidentuara gjatë 10 viteve të fundit, raporte dhe inspektime të mëparshme të kryera nga ekipi i specialistëve të KESH sh.a, etj.

Në fund të kësaj faze do të pregatitet një Projekt-Ide i shoqëruar me Raport përshkrues i cili do të sigurojë një vështrim të përgjithshëm nga pikëpamja e zhvillimit të projektit dhe do të adresojë aspektet organizative dhe teknike të projektit, duke përfshirë edhe problemet që mund të ndeshen së bashku me rekomandimet përkatëse për zgjidhje, mobilizimin e stafit dhe ngjarjet/aktivitetet kryesore që do të kryhen. Ky raport fillestar do të detajojë më tej specifitime dhe investigimet në vend që do të nevojiten të kryhen me qëllim kryerjen e një vlerësimi teknik të situatës aktuale duke e shoqëruar me zgjidhjen teknike dhe përlllogaritjen ekonomike paraprake dhe propozimin e alternativës për zgjidhje në fazat e mëtejshme.

Në fund të kësaj etape, që puna të konsiderohet e mbyllur dhe që ti hapet rruga etapës së dytë të fazës së parë, duhet që Projekt-Idea e propozuar nga kontraktori, të miratohet nga ekspertët e investitorit në HEC Fierzë dhe në KESH sh.a. I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje origjinale të printuara dhe 2 (dy) kopje elektronike në CD. Vizatimet duhet të jepen në format A3 të pregatitur me programet inxhinierike CAD.

### **6.1.2 Etapa e Dytë – Përgatitja e Projekt–Zbatimit (final).**

Menjëherë pas konsultimit dhe pas miratimit nga ekspertët e investitorit në HEC Fierzë dhe në KESH sh.a të Projekt-Idesë së përgatitur nga Kontraktori, fillon puna për finalizimin e Projektit të Zbatimit të detajuar. Ky projekt duhet të zhvillohet konform kushteve teknike të projektimit, legjislacionit në fuqi dhe kërkesave të investitorit.

Që etapa e dytë e fazës së parë të përmbyllet, duhet që varianti final i Projektit të Zbatimit, të miratohet nga ekspertët e caktuar në HEC Fierzë dhe në KESH sh.a. Për këtë duhet që projektuesit të kenë zbatuar kushteve teknike të projektimit, legjislacionit në fuqi dhe kërkesave të investitorit të diskutuara në etapën e parë të fazës së parë të zbatimit të kësaj kontrate. Bazuar në informacionet e mbledhura, duhet të realizohet një vlerësim i plotë teknik. Çdo ekspertizë dhe investigim në vend, do të jetë në përgjegjësi të ekipit të projektit. Do të jetë në përgjegjësi të grupit të projektimit, pjesë e kontraktorit të punimeve me "çelësa në dorë", sigurimi i cilësisë së investigimeve, përgatitjes së projektit të zbatimit dhe përcaktimin e zgjidhjes teknike për realizimin e projektit. Për kompletimin e këtij vlerësimi, grupi i projektit duhet të marrë në konsideratë rishqyrtimin dhe analizën e të gjithë të dhënave dhe informacioneve të siguruara në mënyrë që të përcaktojë nëpërmjet analizës teknike shkakun e problematikave të shfaqura dhe të përcaktojë mundësitë alternative për zgjidhjen. Zgjidhja finale duhet të paraqitet së bashku me të dhënat, studimet dhe informacionet mbështetëse të cilat janë përdorur për vlerësimin, duke siguruar konsideratat mbi besueshmërinë në përputhje me vleresimet ekonomike, teknike dhe sociale e mjedisore. Përgatitja e raporteve interpretuese dhe analizuese duhet të jenë

të shoqëruara edhe me analizat përkatëse, studimet dhe investigimet e kryera të cilat duhet të jenë pjesë e një raporti teknik progresiv. Ky raport duhet të përmbajë dhe të mos kufizohet në:

- Përshkrimi dhe analiza e gjendjes aktuale.
- Analizën dhe vlerësimin në lidhje me studimet, modelimet dhe projektet e mëparshme
- Rezultatet e matjeve dhe hartat gjeodezike.
- Hartën e zonës, vizatimet inxhinierike.
- Zgjidhja e propozuara për mbrojtjen dhe sistemimin e zonës në anën e majtë të rrjedhës.

Zgjidhja e propozuara duhet të paraqitet së bashku me të dhënat dhe informacionet mbështetëse, të cilat janë përdorur për vlerësimin, duke siguruar konsideratat mbi besueshmërinë në përputhje me vlerësimet ekonomike, teknike dhe social - mjedisor.

Ky aktivitet do të konsistojë në përgatitjen e raportit final të projektit të zbatimit, vizatimeve dhe specifikimeve teknike, projekt-preventivin mbështetur dhe gjykuar në ekspertizën e vet profesionale, në interpretimin e rezultateve të siguruar nga investigimi në vend dhe/ose studime të tjera specifike. Preventivi i punimeve duhet të përmbajë të gjitha zërat e punimeve të ndërtimit për mbrojtjen dhe sistemimin e zonës duke u bazuar në çmimet njësi të aprovuara sipas legjislacionit në fuqi. Aktiviteti për këtë fazë do të përfundojë pasi KESH të ketë miratuar projektin e paraqitur.

## **6.2 Aktiviteti në Fazën e Dytë.**

Në këtë fazë do të realizohet zbatimi i projektit. Pra menjëherë pasi të miratohet projekti final i hartuar në fazën e parë, kontraktori do të nisë me realizimin e punimeve të parashikuara për tu kryer. Këto punime do të drejtohen nga Mikqyrësi i Punimeve i miratuar / përzgjedhur nga Investitori.

## **7. AFATET E SIPËRMARRJES NË TË DYJA FAZAT E SAJ.**

### **7.1 Faza e Parë**

Kryerja e këtij shërbimi parashikohet të përfundojë brenda 40 ditëve nga data e lidhjes së kontratës. Pas përfundimit të etapës së parë në fazën e parë, do të dorëzohet Projekt-Ideja / Raporti Fillestar brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës. Pas përfundimit të etapës së parë, puna vazhdon për etapën e dytë të fazës së parë, në të cilën mbeten 25 ditë pune për hartimin e Projektit Final të Zbatimit.

### **7.2 Faza e Dytë**

Në këtë fazë të përmbushjes kontraktuale, do të duhet të realizohen punimet e parashikuara, për të cilën është parë e arsyeshme që të vihet në dispozicion një afat kohor prej 150 ditë kalendarike.

E gjithë kontrata parashikohet të përmbillet brenda 190 ditëve kalendarike. Nëse në rethana të pa parashikuara, do të nevojiten afate kohore shtesë, kjo do të jetë pjesë e një raportimi dhe e dakortësimi nga ana e investitorit KESH sh.a.

## **8. PËRCAKTIMI I FONDIT LIMIT**

Për realizimin e kësaj sipërmarrje punimesh dhe hartimi i projektit të zbatimit, është parashikuar vlera prej 98.000.000 (Nentëdhjetë e tete milion) lekë pa tvsh. Kjo vlerë është rezultat i analizës preventivuse paraprake të hartuar nga Reparti Hidroteknik në HEC Fierzë. Kontraktori duhet ta zhvillojë hartimin dhe zbatimin e projektit, duke e rianalizuar nga fillimi të gjithë situatën duke mos u mjaftuar tek kjo llogaritje paraprake, e cila është realizuar vetëm për përllogaritjen e fondit limit.

## **9. KËRKESA TË PËRGJITHËSHME**

Grupi i projektimit duhet të realizojë një administrim të përgjithshëm të të gjitha aspekteve që lidhen me projektimin/shërbimin e kërkuar. Kontraktori i punimeve "me çelësa në dorë", duhet të caktojë një drejtues / administrator të projektit i cili do të mbajë lidhje me administratorin e kontratës të caktuar nga KESH sh.a.

Standartet për projektimin duhet të jenë në përputhje me standartet që respektohen në Shqipëri. Projektuesi duhet të zbatojë kontrollin e tij të brendshëm të cilësisë dhe procedurat e sigurisë gjatë ekzekutimit të kontratës dhe duhet të demonstrojë që këto janë aplikuar në punën e tij. Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, projektuesi duhet të sigurojë vetë të gjithë infrastrukturën përfshirë dhe pajisjet e zyrës (kompjuter, software), transportin e tij, stafin teknik dhe punëtorin, si dhe mjetet për realizimin e punimeve siç e kërkon zbatimi me sukses i këtij shërbimi.

#### **10. TË DHËNA QË DO TË OFROHEN NGA KESH SH.A.**

KESH do ti sigurojë kontraktorit (projektuesit të caktuar nga kontraktori i punimeve me "çelësa në dorë"), dokumentacionin e disponueshëm që ka lidhje me projektin, si:

- Dokumentacionin teknik që disponon në lidhje me planimetritë, harta dhe vizatime për zonën ku kërkohet të ndërmerren masat mbrojtëse si dhe infrastrukturës përbërëse së saj që lidhet me objektin e shërbimit të kërkuar.
- Raporte, modelimet, studime dhe informacione të tjera përkatëse që disponohen nga KESH sh.a.

Për inspektimet dhe investigimet e përshkuara në aktivitetet e parashikuara, KESH do të sigurojë të gjitha kalimet, lejet, etj., përpara mobilizimit nga Konsulenti të personelit dhe pajisjeve në kantier.

Stafi i caktuar i DSD/KESH do të japë sqarimet e duhura rreth specifikimeve për hartimin e projekt - zbatimit, gjendjes aktuale si dhe studimeve të mëparshme dhe projekteve të realizuara gjatë viteve të fundit, nëse konsiderohet e nevojshme.

#### **Përgatitur nga specialistët e Sektorit të Mirmbajtjes në HEC Fierzë.**